

VENDIM
Nr. 78, datë 7.6.2016

**MBI MIRATIMIN E KONTRATËS “PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE TEKNIKE NË SISTEMIN E
TRANSMETIMIT NDËRMJET OST SHA DHE KESH SHA”**

Në mbështetje të neneve 16; 20 germa “h” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; kapitullit V, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) në mbledhjen e tij të datës 7.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Teknike në lidhje me kontratën “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit,

konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate janë subjekte juridike të legjitimuara për nënshkrimin e kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit”, duke pasur parasysh që licenca e shoqërisë OST sh.a., në aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike është rinovuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 24, datë 26.3.2009 dhe licenca e shoqërisë KESH sh.a., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike është rinovuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 23, datë 25.3.2009.

- Sipas parashikimeve të kapitullit “V”, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar, marrëdhënia midis KESH sh.a. dhe OST sh.a. rezulton të jetë marrëdhënie e rregulluar.

- Duke qenë se “Kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit”, rregullon periudhën 1.1.2016–30.6.2016, vlen të sqarohet se baza ligjore në të cilën ajo gjen mbështetje për periudhën 1.1.2016–30.3.2016, janë nenet 51, gjerat “b” dhe “d”; 56 germa “f”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; parashikimet e Modelit të Tregut të Energjisë, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, i ndryshuar, dhe Rregullat e Tregut, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar.

Që nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, përcaktimet e Modelit të Tregut të Energjisë të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, i ndryshuar, nuk zbatohen më, duke vendosur kështu detyrimin për të miratuar këtë kontratë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

Sqarojmë se vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, nuk ka fuqi prapavepruese dhe si e tillë nuk mund të rregullojë të gjithë periudhën e shkuar në të cilën ka shtrirë efektet kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit. Efektet fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kontratën “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve teknike në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.”, për periudhën kohore 1.1.2016–30.6.2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a. dhe OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti